



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Komisioni Komunal i Aksionarëve

N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A.

GJAKOVA



Dt. 14.09.2026

Komisioni Komunal i Aksionarëve i Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A, në mbështetje të nenit 16 dhe 17 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, në mbledhjen e mbajtur me datën 08.09.2026 shpall këtë:

K O N K U R S

Për Drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A.

KUALIFIKIMET DHE PËRGATITJA PROFESIONALE

- Të jetë person që ka integritet, të mos ketë çfarëdo shkelje fiduciare ndaj personave tjerë fizik dhe juridik;
- Të ketë përgatitje superiore;
- Të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në nivel të lartë të menaxhimit - në fushën e administrimit të biznesit, të financave kooperative, të menaxhimit të thesarit, të bankave, konsulent në biznes ose industri, ose nga fushat e tjera të shkencave, të ketë qenë kontabilist publik, jurist ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër, i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtaritë afariste të NP-së.

KUSHTET

Kandidatët kanë të drejt të zgjedhën në bordet e NPL-së nëse:

- Nuk kanë qenë të dënuar nga ndonjë gjykatë kompetente;
- Nuk kanë shkelur Kodin e Etikës apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga gjykata ose nga ndonjë organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgënjeshttrimin e materialit në çfarëdo dëshmie nën betim, nuk ka qenë në poste menaxheriale në ndonjë kompani që ka falimentuar në 10 vitet e fundit.

Kandidati nuk kualifikohet për drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Lokale, nëse:

- Aktualisht është zyrtar, ose menaxher i NP përkatëse, ose cilëso nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- Aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;

- c. Aktualisht ka, ose gjatë tre vjetëve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- d. Është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- e. Pranon, ose ka pranuar brenda tre (3) vjetëve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1, ose është anëtar në skemën pensionale të NP-së përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- f. Mbanë drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;
- g. Përfaqëson një aksionar i cili posedon dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse;
- h. Ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse më shumë se nëntë (9) vjet nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- i. Është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e “Interesit Financiar” në nenin 2 të këtij Ligji) i cilitdo person që i takon cilëndo nga kategoritë më sipër përveç personit të përcaktuar në pikën (b); ose
- j. Është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkurron në Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuara që konkurrojnë në Ndërmarrjen; dhe
- k. Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit ka qenë(i) zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- l. Ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktoje që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t’i përmbushë detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

DOKUMENTET E KËRKUARA

- CV;
- Letër motivuese;
- Deklaratë nën betim (formular që plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Dëshmitë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHTI);
- Dëshmitë mbi përvojën e punës;
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit ose pasaportës (si dëshmi e shtetësisë Kosovare).

Aplikuesi duhet të përgatitë deklaratën nën betim, në të cilën deklaron që ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësinë dhe përgatitjen profesionale.

Çdo informatë e pavërtetë materiale, qoftë e qëllimshme, qoftë nga neglizhenca, do të rezultojë me diskualifikim të menjëhershëm.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në zyrën e Sekretarit në Ndërmarrjen Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A.

Vëmendje: Të gjitha dokumentacionet e dorëzuara në zarf të hapur nuk do të merren në shqyrtim dhe do të konsiderohen të pavlefshme.

Vërejtje:

Dokumentacioni dorëzohet në kopje, origjinali mund të kërkohet gjatë intervistës. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret sipas këtij konkursi do të kualifikohen për fazat e mëtejshme.

Afati i aplikimit është i hapur 30 ditë kalendarike pas publikimit të shpalljes publike duke filluar nga data: 14.09.2026 deri më 13.10.2026.

 **Arben Bakalli**

Kryesues i Komisionit